




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Grupi Koha” Sh.p.k.
Numri i biznesit - 70284584
Pronare – Flaka SURROI
OSHMA TV ARTA
Rr/ Nëna Terezë, 31/b
Prishtinë

Ref:1911/1377/LIC/ni

VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim
përmes operatorëve të shpërndarjes TV Arta, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV Arta është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 6 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA TV Arta.
3. Me datën 6 tetor 2019, ka skaduar afati i licencës për TV Arta, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 27 nëntor 2019, TV Arta ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

5. OSHMA TV Arta, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së duke shfrytëzuar të drejtën e ripërtëritjes së licencës e paraparë me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në.

6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Vendim

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 12 dhjetor 2019, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së TV ARTA, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
8. Licenca e KPM-së për OSHMA TV Arta do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 6 tetor 2019.
9. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA TV Arta, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



18.12.2019
datë